

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-16/12

Prishtinë, 22 qershor 2012

Në çështjen e

M.M., si përfaqësues i S.B.
Gjilan

Paraqitësi i kërkesë/Pala ankuese

Kundër

S.B.
Gjilan

Pala përgjegjëse në kërkesë/Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Filcheva-Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, Anëtarë, duke vendosur me ankesën ndaj vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/R/122/2011 (lënda është regjistruar në AKP me KPA01186), të datës 07 shtator 2011, pas shqyrtimit të mbajtur me 22 qershor 2012, mori këtë

AKTGJYKIM

- 1- Anulohet vendimi KPCC/D/R/122/2011 lidhur me lëndën e regjistruar në AKP me numrin KPA 01186 për shkak të jokompetencës lëndore.
- 2 - Hedhet poshtë kërkesa e M.M. e bërë në emër të S.B. në kërkesën nr. 01186 për shkak të jokompetencës.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Me 02 nëntor 2007, M.M., ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) në emër të S.B. ku ka kërkuar ri-posedimin e një banese prej 60.30 metrash katror, që gjendet në Gjilan.

Për ta mbështetur kërkesën, z. M. ka paraqitur dokumente të shumta.

Paraqitësi i kërkesës e ka përendur S.B. si uzurpues të pronës.

AKP-ja ka vazhduar me notifikimin e duke vendos një afishe në derën e banesës.

Në raportin e datës 5 gusht 2011, AKP-ja (Sekretaria Ekzekutive) ka rekomanduar se kërkesa duhet të hedhet poshtë pasi për të njejtën çështje dhe në mes të të njejtave palë është vendosur me vendimin e DÇPB-së Nr. HPCC/REC/76/2006 që është marrë.

Sipas këtij vendimi prona e kërkuar i është dhënë në ripozedim Ztr. S.B.-it, i cili është palë përgjegjëse në kërkesën e parashtruar nga paraqitësi i kërkesës.

Nga analizimi i dokumenteve të paraqitura në lëndë, mund të konkludohet se banesa kontestuese fillimisht ishte pronë e Fabrikës L.V.. Është vërtetuar se fillimisht në vitin 1978, në bazë të kontratës ndërmjet Fabrikës dhe Kuvendit Komunal të Vitisë, banesa i ishte “caktuar” Kuvendit në shfrytëzim të përkohshëm. Pastaj në vitin 1981 është lidhur një kontratë qiraje ndërmjet organizatës së punës “L.V.” dhe L.B., burrit të ndjerë të S.B.. Po ashtu pala përgjegjëse në kërkesë S.B. kishte kërkuar që t’i jepej e drejta e blerjes së pronës dhe me vendim të Gjykatës Komunale atij i është vërtetuar e drejta në këtë drejtim.

Në kontekst të këtyre fakteve, deklarata e paraqitësit të kërkesës se posedimi i pronës ishte humbur në ndërlidhje me konfliktin e armatosur të viteve 1998/1999 mbetet plotësisht e pajustificuar. Më sa duket, kishte pasur një kontest civil lidhur me atë se kush kishte të drejtën e blerjes së pronës së kontestuar shumë kohë para shpërthimit të konfliktit të armatosur dhe as ndodhja e as zhvillimi i kontestit civil nuk kishte të bënte asgjë me atë konflikt.

Arsyetim ligjor:

Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur brenda afatit prej 30 ditëve siç parashihet me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079.

Megjithatë, Gjykatat nuk duhet të elaborojë rreth meritave të ankesë, përkatësisht meritave të vendimit të kundërshtuar pasi që ky i fundit është marrë në mungesë të juridiksionit.

Kjo është në këtë mënyrë, sepse sipas nenit 3.1 Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në një urdhëresë nga Komisioni për ri-posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm që dëshmon pronësinë e pronës së paluajtshme private, por edhe që ai nuk është në gjendje aktualisht t'i ushtrojë këto të drejta pronësore për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërsëdrejti apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

Siç vërtetohet nga dokumentet e paraqitura në lëndë, kontesti lidhur me pronën në fjalë kishte filluar shumë kohë para ngjarjeve të viteve 1998/1999. Ai nuk është shkaktuar nga e as nuk është ndikuar nga konflikti i armatosur. Prandaj, kërkesa është jashtë juridiksionit të AKP-së dhe KKPK-ja nuk është dashur të vendos rreth meritave të kërkesës por është dashur që të hedh poshtë atë. Pasi që kjo nuk është bërë, KKPK-ja ka marrë një vendim të pavlefshëm i cili duhet të anulohet sipas argumentit të nenit 198.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Sipas dispozitës ligjor të referuara kur gjykata e shkallës së parë (në këtë rast është juridiksion i posaçëm – AKP) merr vendim jashtë juridiksionit të saj, atëherë gjykata e shkallës së dytë duhet të anulojë vendimin dhe të hedh poshtë kërkesën.

Në mungesë të juridiksionit do të ishte e panevojshme që të elaborohet nëse ekziston res judiciata lidhur me rastin e njëjtë dhe nëse kërkesa është bazuar në meritat e saj.

Këshillë juridike:

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike.

Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Elka Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it .